

V E N D I M
Nr. 307, datë 1.7.1999

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 768, DATË
8.12.1998 “PËR CAKTIMIN E PËRFAQËSUESVE TË ORGANIZATAVE TË
PUNËMARRËSVE DHE PUNËDHËNËSVE NË KËSHILLIN KOMBËTAR TË PUNËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 200 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1998 “Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 768, datë 8.12.1998, në pikën 1, në titullin “Përfaqësues të organizatave të punëmarrësve” bëhen këto ndryshime :

“PËRFAQËSUES TË ORGANIZATAVE TË PUNËMARRËSVE

1. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH) 4 anëtarë, 4 kandidatë
 2. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) 4 anëtarë, 4 kandidatë
 3. Unioni i Sindikatave të Punonjësve të Shqipërisë (USPSH) 1 anëtar, 1 kandidat.
 4. Sindikata e Pavarur i Minatorëve të Shqipërisë (SPMSH) 1 anëtar, 1 kandidat”
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko